



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

DREJTORATI PËR SHËRBIME PUBLIKE MRBOJTJE DHE SHPËTIM

Data:	04.06.2026
Referencë:	
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	Sead Aliu – Drejtor i DSHPMSH-së
Lënda:	Raporti i muajit Maj 2026

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave të DSHPMSH-së gjatë muajit Maj 2026, DSHPMSH-ja ka kryer aktivitetet që ka pasur të planifikuara dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhës RAPORTUESE

- Pranimi, evidentimi, zgjedhja dhe arkivimi i lëndëve të arritura nga qytetarët apo institucionet të tjera.
- Është bërë barazimi i të hyrave nga hapësirat publike, i fakturave të ndriqimit publik si dhe nga mirëmbajtja e tregjeve.
- Kërkesë Drejtoratit të Prokurimit për inicim të procedurës: mirëmbajtja e parkingut nëntokësorë.
- Janë dhënë pëlqime për shfytëzimin e sheshit “Adem Jashari” për realizimin e aktivitetit për shënimin e ditës ndërkombëtare të infermierisë, për hyrje në Shesh me qëllim të vendosjes së folisë në dritare të biznesit dhe për zhvillimin e aktivitetit shëndetësor për vetëdijësimin e qytetarëve.
- Është hartuar dhe dërguar për procedurat e miratimit projekt rregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve publike në qytetin e Lipjanit.
- Janë dhënë Vendime për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike para lokaleve afariste.
- Janë përgatit paramasa nga menaxherët.
- Është intervenuar në eliminimin e prishjeve në rrugën “Hamzë Jashari”, janë vendosur 3 shtyllat e riparuar komplet në rrugën “Haradin Bajrami” si dhe është larguar poqi led në rrugë për shkak të aksidentit. Është rregulluar kabloja e këputur në fshatin Ribar i Vogël dhe janë ndërruar poqat e djegur, si dhe janë vendosur dy shtyllat e riparuar dhe janë ndërruar poqat e djegur në fshatin Konjuh.

Me kërkesën e këshillit organizativ të turneut është riparuar ndriqimi i fushës sportive në fshatin Ribar i madh. Janë vendosur dhe intervenuar në shtyllat e aksidentuara në fshatin Sllavi, në rrugën “Bajram Gashi” në Lipjan, Llugaxhi dhe në Smallushë si dhe është vendosur shtylla e riparuar në fshatin Glllogovc dhe janë ndërruar poqat e djegur led.

[illegible]

[illegible]